



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 64.2 pika (a) dhe (b), 4.5, dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 11.2, 29.2 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerrë:

**RREGULLËN ZGJEDHORE NR. 15/2010 ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME DHE
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME**

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1.1 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme qeverisen përmes ligjeve të njëjta dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave.

1.2 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme të Përgjithshme dhe Lokale (më tej: Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme) shpallen nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 4.4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, përkatësisht nenin 4.5 të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

1.3 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës ose Kuvendit Komunal, përkatësisht shkaktimit të rrethanave që kanë ndikuar në mbajtjen e këtyre zgjedhjeve.

1.4 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave mbahen pas ndërprerjes së mandatit të Kryetarit të Komunës për shkaqet e përcaktuara me 56.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për

“Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë”.

1.5 Afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme i referohen afatit prej tridhjetë (30) deri në dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes së kuvendit, përkatësisht përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Komunës.

1.6 Me afatet kohore të përcaktuara me këtë rregull zgjedhore nënkuptohen Ditët Kalendarike.

Neni 2

Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV)

2.1 KQZ-ja emëron KKZ-në brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së datës së zgjedhjeve.

2.2 KQZ-ja do t'i emërojë KVV-të, jo më vonë se dhjetë (10) ditë para Ditës së Zgjedhjeve të Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme në bazë të rekomandimeve që merren nga KKZ-të përmes SKQZ-së në pajtim me kriteret e përcaktuara me nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

2.3 Në secilin vendvotim do të shërbejë një (1) Këshill i Vendvotimit (KVV), i cili do të reflektojë përbërjen e KKZ-së siç përcaktohet në nenin 74.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Neni 3

Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve

3.1 Të gjitha dispozitat lidhur me certifikimin e subjekteve politike të parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 08/2009 “Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre” me përjashtim të afateve kohore për certifikim, vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

3.2 Brenda shtatë (7) ditëve nga data e shpalljes së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, Partia Politike, e cila nuk dëshiron të certifikohet për zgjedhje duhet ta njoftojë Zyren që nuk garon në zgjedhje, apo partia do të kërkojë certifikim përmes koalicionit.

3.3 Periudha e aplikimit për certifikim duhet të përfundoj deri në tridhjetë (30) ditë para ditës së zgjedhjeve.

3.4 Periudha e shqyrtimit të aplikacioneve për certifikim është katër (4) ditë nga dita e pranimit të aplikacionit.

3.5 Përmirësimet/korrigjimet e aplikacioneve do të pranohen nga Zyra brenda dy (2) ditëve.

3.6 Zyra i rekomandon KQZ-së certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve jo më vonë se njëzet e dy (22) ditë para ditës së zgjedhjeve.

3.7 Pas pranimit të rekomandimit, KQZ-ja miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda njëzet e katër (24) orëve.

3.8 Afati për ushtrimin e ankesës nga ana e subjektit politik në KZAP është njëzet e katër (24) orë nga pranimi i vendimit të KQZ-së.

3.9 Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor, jo më vonë se njëzet e katër (24) orë para datës së caktuar për tërheqje të shortit.

3.10 Listat e certifikuara të subjekteve politike dhe kandidatëve duke përfshirë edhe ndryshimet në to, publikohen nga KQZ-ja në afat prej njëzet e katër (24) orësh pas certifikimit.

Neni 4

Renditja e subjekteve në Fletëvotim

4.1. Të gjitha dispozitat lidhur me renditjen e subjekteve politike në fletëvotim dhe procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit të parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 08/2009 “Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre” vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në Fletëvotim në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

4.2 Tërheqja e shortit të renditjes së subjekteve politike në fletëvotim, mbahet jo më vonë se njëzet (20) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

Neni 5

Votimi jashtë Kosovës

5.1 Të gjitha dispozitat e parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 03/2008 “Votimi jashtë Kosovës” vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për votimin jashtë Kosovës në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

5.2 Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës duhet të përfundojë jo më vonë se njëzet e pesë (25) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 6

Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta

Të gjitha dispozitat e parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 04/2008 “Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta” vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta në zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

Neni 7

Fushata Zgjedhore

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme zgjatë dhjetë (10) ditë dhe përfundon një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 8

Vëzhguesit e zgjedhjeve

8.1 Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare që janë akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (Zyra) mund t'i vëzhgojnë Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

8.2 Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare mund të dorëzojnë në KQZ kërkesën për t'u akredituar për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme, jo më vonë se pesë (5) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

Neni 9

Akreditimi i Vëzhguesve

9.1 Të gjitha dispozitat lidhur me akreditimin e vëzhguesve të parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 07/2009 "Vëzhguesit e Zgjedhjeve" vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për akreditimin e vëzhguesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

9.2 Afati i fundit për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike është dhjetë (10), ndërsa për vëzhguesit e organizatave ndërkombëtare pesë (5) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

Neni 10

Lista e Votuesve

10.1 Për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme do të përdoret Lista e azhurnuar e Votuesve, siç është përcaktuar me nenin 7.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

10.2 Të gjitha dispozitat e parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 02/2008 "Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës së Votuesve" vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për Periudhën e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës Votuese për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

10.3 Periudha e Shërbimit të Votuesve duhet të përfundojë jo më vonë se njëzet e pesë (25) ditë para ditës së përfundimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës Votuese .

10.4 Periudha e Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës Votuese duhet të përfundojë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 11

Qendrat e Votimit (QV) dhe Vendvotimet (VV)

KQZ-ja i publikon lokacionet e sakta të të gjitha Qendrave të Votimit (QV) jo më vonë se dhjetë (10) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 12

Votimi dhe numërimi brenda vendvotimit të gjitha dispozitat e parapara në Rregullën Zgjedhore

Votimi dhe numërimi brenda vendvotimit dhe të gjitha dispozitat e parapara në Rregullën Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe numërimi brenda vendvotimeve” vlejné në mënyrë të njëjtë (*mutatis mutandis*) edhe për votimin dhe numërimin në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme.

Neni 13

Raundi i Dytë i Zgjedhjeve

Në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50% plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë, KQZ-ja organizon Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme.

Neni 14

Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar

14.1 Përveç kërkesave të përcaktuara me Rregullën Zgjedhore nr.12/2009 Kufizimi Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar, të gjitha subjektet politike , kandidatët të cilave janë certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme, duhet të dorëzojnë Zyrës formularin e kompletuar të Deklarimit Financiar të Fushatës, për periudhën që fillon me ditën e shpalljes së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës dhe që përfundon me ditën e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme ose të Parakohshme.

14.2 Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull Zgjedhore hyn në fuqi më datën 18.10.2010

Valdete Daka

Kryetare e KQZ-së

